VENDIM
Nr. 40/2014

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT PËR VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË EMËRIMEVE NË DETYRË NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE, ENTET PUBLIKE APO SHOQËRITË TREGTARE SHTETËRORE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 8 e 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet komisioni hetimor parlamentar për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë, të realizuara gjatë periudhës 2009-2014, në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore.

II. Objekti i veprimtarisë së komisionit hetimor është verifikimi i zbatimit të legjislacionit në procesin e emërimeve gjatë periudhës 2009-2014 në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore, por pa hetuar apo nxjerrë konkluzione mbi çështje që ndodhen në gjykim, apo për të cilat gjykata është shprehur me vendim të formës së prerë.

III. Komisioni hetimor, i ngritur sipas këtij vendimi, bashkë me raportin përfundimtar i paraqet Kuvendit në seancë plenare, rekomandime në lidhje me nxjerrjen e përgjegjësive institucionale, ndryshime apo miratime ligjesh dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore.

IV. Komisioni hetimor përbëhet nga 9 anëtarë, si më poshtë:

1. _____	kryetar	PD
2. _____	zëvendëskryetar	PS
3. _____	anëtar	PS
4. _____	"	PS
5. _____	"	PS
6. _____	"	LSI
7._____	"	PD
8. _____	"	PD
9. _____	"	PD

V. Komisioni e ushtron veprimtarinë e tij për një afat 4-mujor nga momenti i konstituimit.

VI. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit që menjëherë të caktojë mjediset dhe mjetet e punës së komisionit, si dhe personelin e nevojshëm, duke vënë në dispozicion edhe ekspertë juristë.

VII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Kuvendit dhe të urdhrave të Kryetarit të Kuvendit, për mbarëvajtjen e punës së komisionit, si dhe krijimin e kushteve të nevojshme logjistike për veprimtarinë normale të tij.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 12.6.2014

KRYETARI
Ilir Meta